



FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS  
DEPARTAMENTI I INFORMATIKËS

**CIKLI I BACHELOR INFORMATIKË  
PROGRAMI I LËNDËS: FIZIKË**

Aktiviteti mësimor	Leksione	Ushtrime	Laboratore	Praktikë	Totale
Detyrimi i studentit	Jo të detyrueshëm %	75% %	100% %	100% %	
Orë Mësimore	60	60			120

<b>Studim Individual</b>	130 (orë)
<b>Gjuha e zhvillimit të mësimi</b>	Shqip
<b>Tipologjia e lëndës / Lloji i lëndës/ Kodi i lëndës</b>	A / E detyrueshme /
<b>Kodi i etikës</b>	Referuar Kodit të etikës së UT, miratuar me Vendim Nr. 12, datë 18.04.2011, studentët kanë për detyrë të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës, Universiteti i Tiranës: a. Të zbatojnë orarin e mësimi dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e U.T. b. Të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambjentet e institucionit, që nënkupton një veshje të përshtatshme, joekstravagante, si dhe përdorimin e një fjalori të përshtatshëm sipas normave të etikës, moralit dhe të mirësjelljes. c. Të respektojnë pedagogët, shokët dhe rregullat e mësimi. .... <a href="https://unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/KodiEtikes.pdf">https://unitir.edu.al/images/dokumenta/Legjislacion/KodiEtikes.pdf</a>
<b>Mënyra e shlyerjes</b>	Provim
<b>Kredite</b>	10
<b>Zhvillimi i Mësimi</b>	Viti i 1 semestri 1 dhe 2, 4 orë në javë: 2 orë leksione në javë , 2 ushtrime në javë, orë laborator në javë.
<b>Zhvillimi i Provimi</b>	I kombinuar

**Mënyra e Vlerësimit: Provim**

<b>Pjesëmarrja dhe aktivizimi</b>	5 %
<b>Kontrolli 1</b>	10 %
<b>Kontrolli 2</b>	0 %
<b>Kontrolli 3</b>	0 %
<b>Detyra Kursi</b>	0 %
<b>Laboratore</b>	0 %
<b>Praktika në terren</b>	0 %
<b>Provim final</b>	85 %
<b>Gjithsej</b>	100 %

<b>Konceptet themelore</b>	Është disiplinë bazë e formimit të studentëve të Informatikës. Pjesa e parë e kësaj lënde e njih studentin me dukuritë dhe
----------------------------	--

	<p>ligjet themelore të fizikës klasike, veçanërisht të mekanikës, të valëve, të termodinamikës dhe të elektromagnetizmit. Pjesa e dytë e kësaj lënde e njeh studentin me dukuritë dhe ligjet themelore të fizikës moderne. Në veçanti trajohen bazat fizike të Mekanikës kuantike, teoria e mekanikës kuantike dhe zbatime të saj për atomet, përcjellsit, gjysmëpërcjellsit dhe pajisjet me gjysmëpërcjellsa. Kjo pjesë e lëndës jo vetëm kontribuon në formimin e përgjithshëm të studentëve të informatikës, por lehtëson përvehtësimin prej tyre të funksionimit të teknologjive të reja kompjuterike, në veçanti gjeneratën e ardhëshme të kompjuterave kuantikë. Të gjithë kapitujt e lëndës shoqërohen me ushtrime përkatëse, ku studenti zbaton në situata të ndryshme njohuritë teorike të përfuara në leksione.</p>
Objektivat	<p>Lënda synon njohjen dhe përdorimien e koncepteve dhe ligjësive bazë të Fizikës së përgjithshme Klasike dhe të Fizikës së përgjithshme Moderne. Gjithashtu, ajo synon njohjen e ligjësive të disa dukurive specifike që lidhen me teknologjinë e kompjuterave.</p>
Njohuri Paraprake	<p>Njohuri bazë të fizikës dhe matematikës së shkollës së mesme.</p>